



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Nr. 468/7 Prot.

Tiranë, më 20.12.2018

**VENDIM**

**Nr.100, datë 20.12.2018**

**PËR**

**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË  
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 85, DATË 23.10.2018, NË  
INSTITUCIONIN TË ISHMPU-QENDËR**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit nr.85, datë 23.10.2018, “Mbi verifikimin e ligjshmërisë së aktit nr.129, datë 11.04.2018 të Kryeinspektorit të ISHMPU-Qendër, për ndërprerjen e menjëhershme të marrëdhënies financiare për shkak dorëheqje dhe kërkesës për lëvizje në detyrë të nëpunësit \*\*\*\*\*”, në Inspektoriatin Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave –Qendër,

**KONSTATOVA SE:**

Me kërkesën nr. 468 prot, datë 24.05.2018, regjistruar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil nga \*\*\*\*\* ka nisur verifikimi i ligjshmërisë së veprimit administrativ mbi ndërprerjen e menjëhershme të marrëdhënies financiare ndaj nëpunësit \*\*\*\*\* përfunduar me aktin nr. 129, datë 11.04.2018, të Kryeinspektorit të ISHMPU-Qendër”. Ky proces është përmbyllur me Vendimin nr.85, datë 23.10.2018, të Komisionerit, “Mbi verifikimin e ligjshmërisë së aktit nr.129, datë 11.04.2018 të Kryeinspektorit të ISHMPU-Qendër, për ndërprerjen e menjëhershme të marrëdhënies financiare për shkak dorëheqje dhe kërkesës për lëvizje në detyrë të nëpunësit \*\*\*\*\*”, në të cilin është vendosur:

*1. Të kërkoj nga Njësia e Burimeve Njerëzore e institucionit të ISHMPU-Qendër, të drejtojë procesin për ndryshimin e paragrafit të fundit të aktit administrativ nr. 129, datë 11.04.2018, të Kryeinspektorit “Urdhër, për ndërprerjen e*

*marrëdhënieve financiare” për nëpunësin \*\*\*\*\*, duke shënuar se: Efektet financiare të këtij akti fillojnë 30 ditë pas njoftimit të dorëheqjes.*

*2. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative dhe financiare, lihet afat 15 ditë nga marrja dijani për këtë vendim.”*

*3. Me kalimin e këtij afati, njësia përgjegjëse është e detyruar të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.*

Pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është depozituar shkresa nr. 6040/1 prot., datë 31.10.2018, nga Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave Qendër, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna në dispozitivin e vendimit nr. 85, datë 23.10.2018, të Komisionerit.

Nga shqyrtimi i kësaj shkrese dhe akteve bashkëlidhur saj, vërej se:

Në zbatim të pikës 1 të vendimit objekt verifikimi, Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave Qendër dhe Njësia Përgjegjëse e këtij institucioni, ka nxjerrë Urdhrin nr. 400, datë 31.10.2018, “Për shfuqizimin e pjesshëm të Urdhërit për ndërprerjen e marrëdhënieve financiare” ndaj nëpunësit \*\*\*\*\* ku efektet financiare të aktit të fillojnë 30 ditë pas njoftimit të dorëheqjes.

Nga përmbajtja e këtij urdhëri konstatohet se akti administrativ i konstatuar në mosrespektim të nenit 64 të ligjit nr. 152/2013, në pikën 3 të tij është rregulluar.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

### **VENDOSA:**

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit nr.85, datë 23.10.2018, “Mbi verifikimin e ligjshmërisë së aktit nr.129, datë 11.04.2018 të Kryeinspektorit të ISHMPU-Qendër, për ndërprerjen e menjëhershme të marrëdhënies financiare për shkak dorëheqje dhe kërkesës për lëvizje në detyrë të nëpunësit \*\*\*\*\*”, në ISHMPU-Qendër.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë përgjegjëse të institucionit

të Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave–Qendër, duke zbatuar rekomandimet e Vendimit Nr. 85, datë 23.10.2018.

3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni i ISHMPU-së Qendër, Departamenti i Administratës Publike dhe nëpunësi \*\*\*\*\*.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**